



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:186573

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05867857

**Ac.nr.681/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve S.B. dhe B.B., që të dyja nga fshati T., Komuna e Gllogocit, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson A.I., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K.S. "S.", me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson D.M., me bazë juridike kompensim dëmi material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2575/14, të datës 23.09.2020, në seancën e kolegjit e mbajtur me datën 10.06.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurës K.S. "S.", me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2575/14, i datës 23.09.2020, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2575/14, të datës 23.09.2020, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve S.B. dhe B.B., që të dyja nga fshati T., Komuna e Gllogocit dhe ka detyruar të paditurën K.S. "S.", me seli në Prishtinë, që paditëseve, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 30.06.2014, t'iu paguaj shumat e specifikuar si më poshtë: Paditëses S.B., dëmin jo material: kompensimi në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 6,200.00 euro, kompensimin në emër të frikës, shumën prej 5,000.00 euro, kompensimin në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 13,000.00 euro, kompensimin në emër të dhimbjeve shpirtërore për shëmtim, shumën prej 4,000.00 euro. Dëmi material, për ndihmën e personit të huaj, shumën prej 200.00 euro, ushqimi i përforcuar, shumën prej 300.00 euro, kompensim në emër të shpenzimeve të shërimit, shumën prej 989.50 euro, kompensimi për rentën e arritur, për periudhën 30.06.2014 e deri me 31.03.2020, për zvogëlim të aftësisë punuese në shkallë prej 25%, shumën prej 6,127.00 euro, ndërsa kompensim për periudhën e ardhshme duke filluar nga data 01.04.2020, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore në emër të rentës mujore për çdo muaj ti paguaj shumën prej 61.97

euro, e cila duhet të paguhet më së largu deri me datën 5 të muajit vijues për muajin paraprak. Padi tëses B.B., dëmi jo material: kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 8,000.00 euro, kompensim në emër të frikës, shumën prej 6,000.00 euro, kompensim në emër të dhimbjeve shpirtërore për shëmtim, shumën prej 5,500.00 euro, kompensim në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 16,000.00 euro. Dëmi material, për ndihmën e personit të huaj, shumën prej 200.00 euro, ushqimi i përforcuar, shumën prej 300.00 euro, kompensim në emër të shpenzimeve të shërimit, shumën prej 739.90 euro, kompensim për rentën e arritur, për periudhën 30.06.2014 e deri me 31.03.2020, për 27% të zvogëlimit të aftësisë punuese, shumën prej 4,251.00 euro, ndërsa kompensim për periudhën e ardhshme duke filluar nga data 01.04.2020, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore në emër të rentës mujore për çdo muaj ti paguaj shumën prej 79.36 euro, e cila duhet të paguhet më së largu deri me datën 5 të muajit vijues për muajin paraprak. Në pikën II, ka detyruar të paditurën K.S. "S.", që paditëseve për pjesën e aprovuar të kërkesëpadi së t'ia paguaj edhe kamatën në lartësinë prej 8% duke filluar nga data 23.09.2020, dita e nxjerrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 5,026.80 euro, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Në pikën III, ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadi së përtej shumave nga pikë I e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për padi tësen S.B., në emër të kompensimit për dhembjet e përjetuara fizike, shumën prej 1,800.00 euro, në emër të kompensimit për frikën e përjetuar shumën prej 1,000.00 euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 4,000.00 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 5,000.00 euro, për padi tësen B.B., në emër të kompensimit për dhembjet e përjetuara fizike shumën prej 2,000.00 euro, në emër të kompensimit për frikën e përjetuar shumën prej 2,000.00 euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 4,500.00 euro, dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 11,000.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit për shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e atakuar C.nr.2575/14 të datës 23.09.2020, ta ndryshoj dhe të gjykoj shuma më të ulëta si satisfaksion real për kompensimin e dëmit ndërsa pjesën për fitimin e humbur ta refuzoj si të pabazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim e rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padi tëset, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 22.09.2014, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim dëmi të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 30.06.2014. Në padi kanë parashtruar së aksidenti në fjalë në të cilin padi tëset kanë pësuar lëndime trupore është shkaktuar nga pakujdesia e ngasësit të automjetit i cili ka qenë i siguar tek e paditura në atë mënyrë që

duke lëvizur me shpejtësi përtej normave të lejuara i ka goditur paditëset derisa të njëjtat ishin duke kaluar rrugën. Pas nxjerrjes së provave me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë, kirurgjisë abdominale, dhe psikiatrisë, ekspertizë nga lëmia e punës dhe ekspertizë të aktuaristikës, me parashtresën e datës 08.09.2020, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses S.B. t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 45,646.50 euro, ndërsa paditëses B.B. shumën e përgjithshme prej 60,490.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëseve, për nga baza dhe lartësia.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëseve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me provat e administruara, është vërtetuar së aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 30.06.2014, rreth orës 15:15, në magjistralen Glllogoc - Skenderaj, deri të aksidenti ka ardhur kur ngasësi i automjetit transportues – kombi me targa ..., i cili nga pakujdesia dhe duke lëvizur me shpejtësi të madhe, me pjesën e përparme i godet këmbësoret – tani paditëset, të cilat në ato momente ishin duke kaluar rrugën, me ç'rast tani paditëset kanë pësuar lëndime të rënda trupore. Gjykata ka konstatuar së fakti se automjeti ka qenë i siguar tek e paditura, nuk ka qenë rrethanë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, ndërsa fajësia e shoferit të mjetit "A" vërtetohet nga raporti i aksidentit nr.2014-AR-1419 i dt.30.06.2014 dhe Ekspertiza e komunikacionit të punuar në lëndën PP/II.nr.4900/14 i dt.09.07.2014, punuar nga ekspertja e komunikacionit L.K., në të cilën është konstatuar fakti se në shkaktimin e këtij aksidenti ka kontribuar drejtuesi i mjetit të tipit kombi, i cili ka lëvizur me shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar në zonën e vendbanimit dhe për më tepër shoferi nuk ka poseduar patent shofer, ndërsa e paditura e cila e ka kontestuar pjesërisht bazën e kërkesëpadisë, e njëjta nuk ka propozuar nxjerrjen e ndonjë prove të re me ndonjë super ekspertizë, andaj gjykata ja ka falur besimin provave të lartcekura sa i përket bazës së kërkesëpadisë duke vlerësuar se ekspertiza e lartcekur është punuar në mënyrë profesionale dhe është bindëse. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit jo material dhe material ka vendosur duke marrë për bazë ekspertizat mjekësore të dhëna nga Dr. V.B., ortoped-traumatolog, Dr. B.B.-ekspert i kirurgjisë abdominale dhe Dr. N.M.-psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional me ekspertizën e datës 29.03.2019, lidhur me natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që kanë pësuar paditëset si pasojë e aksidentit. Paditësja Syzana Bylykbashi ka pësuar lëndime të rënda trupore, duke konstatuar se ka pësuar thyerje në dy nivele të kofshës së djathtë, thyerje të kockës pubike të dyanshme, thyerje të kockës sakrale të anës së djathtë, thyerje shumëfragmentëshe të kockës ishiadike të majtë, shok hemorragjik pas rupturës së zorrës ascenente dhe hematom retroperitoneale e anës së djathtë e operuar, duke pësuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 1 orë, dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 5 ditë, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 35 ditësh, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët vazhdon edhe sot e kësaj dite gjatë ndryshimeve klimatike

dhe ecjeve të gjatë. Ka përjetuar frikë primare nuk ka pësuar pasi që nuk i kujtohet aksidenti, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar 3 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frikë të intensitetit të ulët është prezent edhe sot e asaj dite, e njëjta ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 60 ditësh, për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 90 ditësh, ka pasur nevojë për rehabilitim fiziatrik 10 ditësh, ndërsa e njëjta ka pasur shëmtim trupor dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 20%. Paditësja B.B., ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përjetshme duke konstatuar se ka pësuar edemë trurorë HSD (gjakderdhje nën cipën trurorë) e regjionit parieto-tempora e anës së djathtë, HAD (gjakderdhje nën cipës së trurit të anës së djathtë), HIC (gjakderdhje trurorë) e regjionit parieto-temporra të djathtë, frakturë e kllavikulës së djathtë, frakturë e degës së sipërme dhe të poshtme të ashtit pubik të dy anëve të pevikut, frakturë e femurit të djathtë për të cilat janë bërë intervenime kirurgjike, duke pësuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë disa sekonda, dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 5 ditë, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 40 ditësh, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët vazhdojë edhe sot e kësaj dite, në sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike sidomos ecjeve të gjata. Nuk ka përjetuar frikë primare meqenëse nuk i kujtohet asgjë, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar 5 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 2 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët vazhdon edhe sot e kësaj dite, e njëjta ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 12 javë, për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 90 ditësh, ka pasur nevojë për rehabilitim fiziatrik 14 ditësh, ndërsa e njëjta ka pasur shëmtim trupor dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 27 %. Gjykata ka nxjerrë edhe ekspertizën e për aftësinë punuese të nxjerrë nga eksperti Dr. Xh.P. dhe Dr. Xh.Sh. si dhe ekspertizën e aktuaristikës nga eksperti A.B.. Gjykata e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëset, si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, për dëmin material dhe jomaterial përtej shumave të gjetuara, sepse bazuar në mendimet e ekspertëve mjekësor ka vlerësuar se shumat e kërkuara nga paditëset për dëmin jomaterial përtej shumave të gjetuara nuk janë në proporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës dhe lartësinë e kërkesëpadiës, ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136, 169, 172, 179 dhe 183 të LMD-së. Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkalles së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata e shkalles së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës sa i përket përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit të datës 30.06.2014, në të cilin aksident kanë pësuar lëndime trupore paditëset. Kjo pasi që gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar sa i përket

përgjegjësishë për shkaktimin e aksidentit është bazuar në ekspertizën e komunikacionit të datës 09.07.2014, të nxjerrë në çështjen penale PP/II.nr.4900/14, të cilën ekspertizë e ka përpiluar ekspertja e komunikacionit L.K., e cila ka konstatuar së në shkaktimin e këtij aksidenti ka kontribuar drejtuesi i mjetit të tipit kombi “VW 70X02A, i siguruar tek e paditura. Gjykata e Apelit, nuk pajtohet me konstatimin e gjykatës së shkallës së parë së baza juridike sa i përket përgjegjësishë për shkaktarin e aksidentit është vërtetuar me ekspertizën e komunikacionit të nxjerrë në procedurë penale, kjo për faktin së në ekspertizën në fjalë të cilës gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin është konstatuar së në shkaktimin e aksidentit ka kontribuar drejtuesi i automjetit kombi i siguruar tek e paditura, mirëpo, nuk janë dhënë sqarime të duhura së në shkaktimin e këtij aksidenti a kanë kontribuar edhe këmbësoret-paditëset, marrë parasysh vendin ku ka ndodhur aksidenti, apo aksidenti është shkaktuar vetëm me lëshimet ekskluzive të drejtuesit të automjetit i cili ka qenë i siguruar tek e paditura.

Andaj, duke marrë parasysh faktin së nga ekspertiza e komunikacionit e nxjerrë në procedurë penale nuk mund të konstatohet nëse aksidenti në fjalë është shkaktuar me lëshimet ekskluzive të drejtuesit të automjetit të siguruar tek e paditura, apo në shkaktimin e këtij aksidenti kanë dhënë kontribut edhe paditëset, dhe duke marrë parasysh faktin së e paditura gjatë shqyrtimit kryesor e ka kontestuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, duke pretenduar se paditëset si këmbësore gjatë kalimit të rrugës jashtë vendkalimit për këmbësore kanë kontribuar në shkaktimin e aksidentit, gjykata e shkallës së parë është dashur që të bëjë nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit në procedurë kontestimore për ta vërtetuar faktin së me lëshimet e cilit pjesëmarrës është shkaktuar aksidenti dhe nëse paditëset në këtë rast kanë kontribuar në shkaktimin e aksidentit, duke ia caktuar saktë detyrat ekspertit, në kuptim të nenit 356, 357, 358, 361, 363 dhe 364 të LPK-së. Për arsyet e cekura si më lartë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë u deshtë që të prishet në tërësi dhe lënda të kthehet në rivendosje, ngase gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur mundësi që të njëjtin ta vërtetoj apo ta ndryshoj.

Gjykata e Apelit, në këtë rast e pati parasysh edhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, P.nr.394/2015, të datës 02.11.2015, me të cilin personi i cili e ka drejtuar automjetin e siguruar tek e paditura është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8, lidhur me par.1 të KPRK-së, mirëpo, kjo rrethanë nuk e përjashton mundësinë që paditëset si palë të dëmtuara në këtë aksident të kenë dhënë kontribut eventual në shkaktimin e aksidentit.

Në riprocedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të bëjë eliminimin e shkeljeve të sipër theksuara, të caktoj shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, në atë mënyrë që fillimisht të konstatoi se në këtë rast a është kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, nëse edhe me tej mbetet kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, ta caktoj nxjerrjen e provës me ekspertim nga lëmia e komunikacionit rrugor, të ftoj ekspertin për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë dhe pas kësaj gjykata të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike, që pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve. Gjykata

po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të nenit 194 dhe 195, paragraf 1, pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.681/2021, datë 10.06.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci